



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr 540/ Prot

Fushe-Arrez, me 25.02.2026

Drejtuar: Këshilli të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 7 datë 18/02/2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin “për disa ndryshime në VKB Nr.43, datë 26.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë Fushë-Arrez, Njësive Administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2026”

Analiza ligjore: Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Per veteqeverisjen vendore ", neni "64" germa "J", Ligjin 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Ligjin nr. 35/2023, "Per kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe perfitimive të të punësuarve në Institucionet e administratës publike, si dhe pages bazë minimale në shkallë vendi", VKM nr 103 date 11.02.2026, “Per disa ndryshime në VKM nr.328, date 31.05.2023, për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njesive të Veteqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijeve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emeruar, të nepunesve civil e të punonjesve administrative të njesive të veteqeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr 87, date 06.02.2026, “Për disa ndryshime në VKM nr.326, date 31.05.2023, për pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve të tjere të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administrates Publike”, të ndryshuar, VKM nr. 425, date 26.06.2024 “Per miratimin e struktures dhe të niveleve të pagave të punonjesve mësimorë dhe të punonjesve të tjere jo mesimore në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimore parauniversitar", VKM nr. 104 date 11.02.2026 “Për disa ndryshime në VKM nr.419, date 26.06.2024, për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pages bruto mujore të punonjesve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”, VKM nr. 502, date 1.8.2024, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.325. date 31.05.2023, “Per miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendesministrit, funksionarve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nepunesve të disa institucioneve të administrates publike", në VKM nr. 776, date 19.12.2025, “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi", si dhe në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.1, date 18.02.2026, “Per miratimin e Struktures Organizative të Bashkisë Fushe-Arrez, Njesive Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varesi të Bashkisë për vitin 2026”.

Situata aktuale e funksionit dhe Situata financiare:

Bashkia Fushe Arrëz paraqiti këto ndryshime;

1. Niveli i pagave të Administrates së Bashkisë dhe Administrimit pyjorë, paraqitet si mëposhtë:

Kryetar i Bashkise 246,000 leke.

Zv. Kryetar i Bashkise 189, 625 leke.

Shef Kabineti, Klasa III-2, lidhja 6, Pozicioni 109.000 leke.

Administrator ne Njesite Administrative te Bashkise 143 ,500 lekë.

Sekretar i Këshillit te Bashkise Klasa II-2, lidhja 6, Pozicioni 144, 525 lekë.

Keshilltar i Kryetarit te Bashkise Klasa III-2, lidhja 6, Pozicioni 109 000 lekë.

Sekretar i Kryetarit të Bashkise Klasa IV-4, lidhja 6, Pozicioni 65 000 leke.

Drejtor drejtoric i Bashkise me status nepunes civil, Klasa II-2, lidhja 6, Pozicioni 144 525 leke.

Drejtor drejtorie i Bashkise pa status te nepunesit civil, te jete sipas Lidhjes 6, Klasa II-2, Pozicioni 144 525 leke.

Pergjegjës sektori dhe Kryeinspektor i Bashkise me status nepunesi Klasa III-2, lidhja 6, Pozicioni 109 000 leke.

Përgjegjës sektori dhe Kryeinspektor i Bashkise pa status nepunësi Klasa III-3, lidhja 6, Pozicioni 105, 000 leke.

Specialist dhe Inspektor i Bashkise me status nepunesi Klasa IV-3, lidhja 6, Pozicioni 75 000 lekë.

Specialista me arsim te larte, në Njësitate Administrative, Klasa IV-4, lidhja 6, Pozicioni 65 000 lekë.

Inspektor me arsim te mesem ne Njesite Administrative, Klasa IV-4, lidhja 6, Pozicioni 55 000 lekë.

Keshilltarët e Këshillit Bashkiak trajtohen me shperblim prej 10% te pages se Kryetarit te Bashkise , ose ne masen 24,600 leke/muaj.

Kryetarët e fshatrave trajtohen me shperblim prej 5% te pages se Kryetarit te Bashkisë, ose ne masen 12, 300 leke/muaj.

Ne Drejtorine c Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave, shkrihet pozicioni i Pergjegjesit te Monitorimit ne terren dhe shtohen 2 (dy) Rojtar Pyjesh per monitorim dhe zvogelim te siperfaqes pyjore ne ngarkim te specialistave perkates. Sipas Ligjit per sherbimin pyjor ngarkesa per nje specialist pyjesh eshte 750 deri me 1000 hektare dhe aktualisht me kete strukture qe kemi ngarkesa eshte mbi 1200 hektare per punonjes, pra me shume s sa duhet te kene ne mbikqyrje.

Ne Drejtorine e Menaxhimit te Mbetjeve, Transportit dhe Sherbimeve Publike Shtohen: 1 (nje) punonjes, ne pozicionin e Manovratorit, 1(nje) punonjes sherbimesh nga part-time kalon ne kohe te plote si punonjes sherbimesh ne Njesine Administrative Qafe-Mali dhe nga Sektori i Sherbimeve Publike 2 (dy) pozicione kalojne ne Sektorin e Menaxhimit te Mbetjeve.

Ne Njesine Administrative Qafe-Mali pozicioni i Sanitares shkrihet dhe krijohet pozicion i ri me emertese Inspektore Arkive dhe Marredhenieve me Publikun.

Tek Arsimi baze shtohen 5 pozicione punc te reja, 3 (tre) Roje: 2 Roje Fushe-Arrez dhe 1 Roje ne Njesine Administrative Fierze , dhe 2 (dy) Kaldaist: 1 Kaldaist ne Njesine Administrative Iballe dhe 1 Kaldaist Fushe-Arrez.

Ne Qendren Kulturore te Femijeve (QKF), 2 pozicionet e Metodisteve kalojne ne pozicionin e Pergjegjesave:

Pergjegjes per Sportet

Pergjegjes per Arsimin dhe Kulturen.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e burimeve njerezore dhe Drejtoria e Financës ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Drejtoria e burimeve njerezore për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Ky Projekt vendim impakton te gjithë te punesuarit ne Bashkine Fushë Arrez.

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 25/02/2026, shqyrtoi projektvendimit nr. 7 datë 18.02.2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për Miratimin e Nivelit të Pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrez, Njësite Administrative Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara per vitin 2026” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Joda Fedi Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Bejona Marku Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK



Nr. 540 Prot.

Fushe-Arrez, me 25.02.2026

PER: KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim në VKB Nr.43, datë 26.12.2025 “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë Fushë-Arrez, Njësive Administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2026”.

Ne zbatim te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mblodh sot, me 25.02.2026, Komisioni i Ekonomise Finances Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare. E pranishme ishte edhe Pergjegjesja e Zyres se Burimeve Njerezore, Zj.Fationa Selimaj, e cila dha shpjegime per projektin qe do te shqyrtohet ne kete mbledhje. Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Fushë-Arrez.

Pergjegjesja e Zyres se Burimeve Njerezore, Zj.Fationa Selimaj,shpjegon se Bashkia Fushë Arrëz në kuader te zbatimit te akteve ligjore dhe nënligjore te ndryshuara në lidhje me nivelin e pagave per te gjitha kategorite e punonjesve dhe nepunësve në Bashkinë Fushe-Arrez dhe Institucioneve ne vartesi te saj, paraqet këtë relacion per here te dyte, brenda pak muajsh.

Bashkia Fushe Arrëz paraqiti këto ndryshime;

Niveli i pagave te Administrates se Bashkise dhe Administrimit pyjore, paraqitet si ne tabelat qw keni para.

Ne Drejtorine e Administrimit te Pyjeve dhe Kullotave, shkrihet pozicioni i Pergjegjesit te Monitorimit ne terren dhe shtohen 2 (dy) Rojtar Pyjesh per monitorim dhe zvogelim te siperfaqes pyjore ne ngarkim te specialistave perkates. Sipas Ligjit per sherbimin pyjor ngarkesa per nje specialist pyjesh eshte 750 deri me 1000 hektare dhe aktualisht me kete strukture qe kemi ngarkesa eshte mbi 1200 hektare per punonjes, pra me shume s sa duhet te kene ne mbiqyrje.

Ne Drejtorine e Menaxhimit te Mbetjeve, Transportit dhe Sherbimeve Publike Shtohen: 1 (nje) punonjes, ne pozicionin e Manovratorit, 1(nje) punonjes sherbimesh nga part-time kalon ne kohe te plote si punonjes sherbimesh ne Njesine Administrative Qafe-Mali dhe nga Sektori i Sherbimeve Publike 2 (dy) pozicione kalojne ne Sektorin e Menaxhimit te Mbetjeve.

Ne Njesine Administrative Qafe-Mali pozicioni i Sanitares shkrihet dhe krijohet pozicioni i ri me emertese Inspektore Arkive dhe Marredhenieve me Publikun.

Te Arsimit baze shtohen 5 pozicione pune te reja, 3 (tre) Roje: 2 Roje Fushe-Arrez dhe 1 Roje ne Njesine Administrative Fierze , dhe 2 (dy) Kaldaist: 1 Kaldaist ne Njesine Administrative Iballe dhe 1 Kaldaist Fushe-Arrez.

Ne Qendren Kulturore te Femijeve (QKF), 2 pozicionet e Metodisteve kalojne ne pozicionin e Pergjegjesave: Pergjegjes per Sportet dhe Pergjegjes per Arsimin dhe Kulturen.

Franc Doda, Kryetar terheq vemendjen per eficenc me te larte te punonjesve te administrates.

Franc Doda, jemi dakord me propozimet e zyres per ndryshimet sipas ketij projekti.

Besjana Marku, me sa di une rojet jane per numer nxenesish.

Besjana Marku, jemi dakord me propozimet e zyres per ndryshimet sipas ketij projekti.

Pasi perfundoi diskutimi anctaret e komisionit rane dakord me shumice votash duke e derguar projektvendimin per shqyrtim te metejshem dhe miratim ne mbledhjen Plenare te dates 27.02.2026.

PER KOMISIONIN

Franc Doda



Zef Cere Juri!

Valentina Meshaj

Besjana Marku

Shyq. 